



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 23 regjistër (JR)  
Datë 08.05.2019

Nr. 27 i vendimit  
Datë 22.10.2020

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Relatore</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Ardian Hajdari</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 22.10.2020, ditën e enjte, në orën 13:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

**ANKUES:** Komisioneri Publik Darjel Sina.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 112, datë 04.03.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Peka.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; nenet C, pika 2, F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e Komisionerit Publik, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 112, datë 04.03.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit dhe shkarkimin e tij nga detyra, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Dritan Peka, i cili kërkoi përfundimisht lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Dritan Peka (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ka ushtruar funksionin e prokurorit, me detyrë drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Në bazë të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex-officio*. Bazuar në parashikimet e neneve 31-44 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka administruar raportet e hartuara nga: a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe c) Grupi i Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

1.1. ILDKPKI-ja, bazuar në nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016, përcolli pranë Komisionit me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 08.01.2018, raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke konstatuar se:

- i. deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin;
- ii. ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. nuk ka kryer deklarim të rremë;
- v. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

1.2. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit dhe, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka përcjellë pranë Komisionit raportin<sup>1</sup>, duke konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

1.3. Prokuroria e Përgjithshme ka përcjellë pranë Komisionit raportin e grupit të punës për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, bazuar në analizën e gjetjeve mbi të dhënat e nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) 5 dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënat nga burimet arkivore në Sektorin e Burimeve Njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

2. Bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni çmoi që procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit do të kryhej bazuar në të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

### II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni, me vendimin nr. 112, datë 04.03.2019, vendosi *konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Peka dhe të transferojë pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore, një çështje që lidhet me përgjegjësitë e subjektit si drejtues, që lidhet me “[...] përzgjedhjen dhe punësimin e z. A.M. pranë Prokurorisë së Apelit Tiranë, [...] kohëzgjatjen e lejes, prezencën [...] dhe me pagesat e përfituara prej tij nga ky institucion, përgjatë periudhës korrik - tetor 2015 [...]”*.

4. Për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit, Komisioni ka vlerësuar në mënyrë të përmbledhur si vijon.

4.1. *Për kriterin e vlerësimit të pasurisë*, subjekti i rivlerësimit ka kryer pasaktësi të vogla në deklaratimet periodike, nga të cilat nuk rezulton si pasojë fshehja apo tentativa për fshehje të pasurisë, që për shkak të peshës së tyre dhe mungesës së pasojave, nuk u konsideruan si deklaratime të pamjaftueshme. Sipas Komisionit, kanë rezultuar mangësi të burimeve

<sup>1</sup> Deklasifikuar me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 20.02.2018.

financiare në një total prej 411.588 lekësh. Duke zbatuar parimin e proporcionalitetit, mungesa e burimeve në fjalë është konsideruar e pamjaftueshme për të zbatuar pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni shprehet se një mungesë financiare “minimale” që i referohet një segmenti kohor prej rreth dy dekadash, mund të tolerohet jo vetëm për mundësinë e ndonjë pasaktësie, por edhe në funksion të parimeve të proporcionalitetit. Në bazë të këtyre parimeve, Komisioni ka konstatuar mungesë elementesh për të zbatuar masën e shkarkimit nga detyra [parashikuar nga pika 1, germa “c” e nenit 58 të ligjit nr. 84/2016].

**4.2. Për kriterin e kontrollit të figurës,** subjekti i rivlerësimi ka plotësuar në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës dhe nga analiza e të dhënave të parashikuara në nenin 38, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe bazuar kryesisht në raportin e DSIK-së, nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

**4.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale,** Komisioni ka konstatuar disa dyshime lidhur me aftësitë etiko-profesionale të subjektit të rivlerësimit, të cilat i çmoi të pamjaftueshme për të konkluduar se ai ka cenuar besimin e publikut apo se nuk arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive të tij profesionale si prokuror. Sipas Komisionit, aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit nuk cenohen vetëm nga pakujdesi organizuese apo neglizhencë e rastit në funksionin e drejtuesit. Nga ana tjetër, në rast se do të rezultonin të provuara dyshimet mbi favorizimet e qëllimshme të sipërpërmendura [në lidhje me punësimin e z. A.M. dhe pagesat e kryera në favor të tij në kundërshtim me ligjin], sipas Komisionit do të kishte vend për të konkluduar mangësi serioze etiko-profesionale, humbjen e besimit të publikut dhe, për rrjedhojë, aplikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Për këto arsye, trupi gjyqës vendosi të transferojë për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore një sërë aspektesh që lidhen me punësimin e z. A.M. pranë Prokurorisë së Apelit Tiranë, në zbatim të pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

5. Në përfundim, sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit:
- i. ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
  - ii. ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
  - iii. ka arritur, së paku, një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **III. Shkaqet e ankimit**

6. Më datë 19.04.2019, Komisioneri Publik Darjel Sina ushtroi ankim<sup>2</sup> kundër vendimit të Komisionit që konfirmoi në detyrë subjektin e rivlerësimit, duke kërkuar marrjen në shqyrtim nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit të shkaqeve të ankimit. Referuar gjendjes së fakteve dhe provave, Komisioneri Publik pretendon se nuk krijohet bindja se për subjektin e rivlerësimit gjen zbatim neni 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Në ankimin e datës 19.04.2019, Komisioneri Publik parashtron se juridiksioni i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në kontrollin/vlerësimin e vendimit të Komisionit do të duhet të ushtrohet në tërësi për të tria kriteret e vlerësimit – pasuri, figurë, profesionalizëm – duke marrë në konsideratë edhe denoncimet e publikut, si një ndër burimet e provës të parashikuara nga ligji nr. 84/2016, që mund të shërbejnë në funksion të konfirmimit ose shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Në përfundim të ankimit, Komisioneri Publik kërkoi që shkaqet e parashtruara të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i cili, pas hetimit të plotë, në përfundim të gjykimit të

---

<sup>2</sup> Nr. {\*\*\*} prot.

çështjes, të vendosë ndryshimin e vendimit nr. 112, datë 04.03.2019, të Komisionit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Dritan Peka.

7. Komisioneri Publik, në ankim ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur këto shkaqe ankimi për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

**7.1. Lidhur me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 94,6 m<sup>2</sup>, ndodhur në Tiranë,** rrethanat që paraqiten të çojnë në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë në kuptim të neneve 30 dhe 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 dhe nuk ka shpjeguar bindshëm krijimin e kësaj pasurie në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

**7.2. Lidhur me kredinë me kushte lehtësuese nga shteti,** rrethanat që lidhen me aplikimin, përfitimin dhe përdorimin e kësaj kredie me kushte lehtësuese çojnë në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, për shkak të cilësive të marra përsipër në kontratën e kredisë (si dorëzanës) dhe kontratën e porosisë (si porosites), ka treguar sjellje që përbën shkelje etike të figurës së prokurorit, e cila, e ndërlydhur me shkelje të tjera të kryera, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit 84/2016, duhet të shërbejë për vlerësimin e përgjithshëm në drejtim të cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

**7.3. Lidhur me analizën financiare për periudhën 2003 – 2016,** subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm në kuptim të neneve 61, pika 3 dhe 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, pasi nga analiza financiare e kryer nga Komisioneri Publik për periudhën 2003 – 2016, rezultoi se kursimi i deklaruar dhe shpenzimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit për vitet 2005, 2006, 2010, 2013, 2014, 2015, 2016, nuk mbulohen me burime të ligjshme në vlerën 3.609.633 lekë dhe se shpjegimet e pretendimet e tij mbi gjendjen e likuiditeteve *cash* në vlerën rreth 1.500.000 lekë në fund të vitit 2016, gjatë procedurës së hetimit administrativ në Komision, mbeten në nivel deklarativ.

8. Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioneri Publik ka parashtruar në ankim se vlerësimi i Komisionit për këtë kriter nuk përputhet me dokumentacionin e administruar në të paktën 1 (një) nga denoncimet e shqyrtuara dhe denoncimit të përcjellë në Institucionin e Komisionerëve Publikë më datë 08.04.2019, nga Kolegji i Posaçëm i Apelit. Konkretisht:

**8.1. Lidhur me denoncimin e familjes P.,** Komisioneri Publik vlerëson se ky rast që lidhet me pozicionin e subjektit si drejtues në prokurori, ka ndikim në rezultatin përfundimtar të rivlerësimit të subjektit në kuadër të vlerësimit të përgjithshëm të të tria kriterëve sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Në cilësinë e drejtuesit, subjekti i rivlerësimit duhej të kujdesej për zbatimin me rigorozitet nga prokurori i çështjes të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, që normojnë veprimtarinë e prokurorëve. Po ashtu, subjekti nuk ka ndërmarrë hapa për të informuar Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, sipas dispozitave ligjore kalimtare për procedimin disiplinor të parashikuara nga ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe pikës 12.2 të udhëzimit nr. 1/2008 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për ushtrimin me efikasitet të së drejtës së ankimit”.

**8.2. Denoncimin anonim të datës 08.04.2019,** për shkelje të etikës profesionale në çështjen që i përket të pandehurit N.P., i akuzuar për veprën penale të mashtrimit, të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, Komisioneri Publik ia bashkoi ankimit për t’u trajtuar më tej nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, pasi ndodhet në kushtet e mungesës së informacionit për arsyet e heqjes dorë nga ankimi, si dhe procedurën e ndjekur nga subjekti i rivlerësimit.

9. Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, Komisioneri Publik kërkoi verifikimin nga Kolegji i Posaçëm i Apelit të të dhënave të një denoncimi të ardhur nëpërmjet postës elektronike të

institucionit më datë 15.4.2019. Nga përmbajtja e këtij denoncimi ngrihen dyshime lidhur me komunikime dhe kontakte të shpeshta të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

## **Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit**

### *A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit*

#### *I) Juridiksioni i Kolegjit*

10. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”) ka juridiksion (*ratione materiae*) të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, i parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit mbi bazën e ankimit të Komisionerit Publik dhe duke mos qenë në kushtet e parashikuara nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

#### *II) Legjitimimi i ankuesit*

11. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit<sup>3</sup>, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

#### *III) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

12. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, çështja objekt gjykimi, duke qenë se ka për objekt shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 112, datë 04.03.2019, për subjektin e rivlerësimit, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “trupi gjykues”) në seanca gjyqësore publike, të zhvilluara në datat 22.07.2020, 14.09.2020, 02.10.2020, 08.10.2020, në prani të palëve dhe përfaqësuesit ligjor të subjektit të rivlerësimit, avokatit Besnik Çerekja.
13. Më datë 24.07.2020, në Kolegji u hodh shorti për zëvendësimin e gjyqtarit Luan Daci, për shkak të pezullimit të tij nga detyra me vendimin nr. 14, datë 24.07.2020, të Mbledhjes së Gjyqtarëve. Pas hedhjes së shortit, gjyqtari Luan Daci është zëvendësuar nga gjyqtarja Ina Rama. Përfundimisht, trupi gjykues i çështjes (JR) nr. 23/2019, datë 08.05.2019, përbëhet nga gjyqtarët e cituar në pjesën hyrëse të këtij vendimi. Në seancën gjyqësore të datës 14.09.2020, subjekti i rivlerësimit konfirmoi njoftimin për këtë ndryshim në përbërjen e trupit gjykues.

---

<sup>3</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 05.04.2019, Komisioni u përcollti Komisionerëve Publikë njoftimin e vendimit për subjektin e rivlerësimit Dritan Peka (bashkëlidhur vendimi dhe CD-ja e materialeve të ndodhura në dosjen e hetimit administrativ dhe në dosjen e ardhur nga ILDKPKI). Ky njoftim është regjistruar pranë institucionit të Komisionerëve Publikë me nr. {\*\*\*} prot., datë 08.04.2019. Ankimi i Komisionerit Publik Darjel Sina është përcjellë pranë Komisionit me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 19.04.2019. Me vendimin nr. 5, datë 23.04.2019, Komisioni vendosi pranimin e ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 112, datë 04.03.2019, në përputhje me nenin 46 të ligjit nr. 49/2012.

*B. Vlerësimi i kërkesave dhe i provave të paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor nga trupi gjykues*

14. Në seancën e parë gjyqësore të datës 22.07.2020, Komisioneri Publik, gjatë prezantimit të shkaqeve të ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, kërkoi nga Kolegji kryerjen e analizës financiare lidhur me mjaftueshmërinë e burimeve financiare të subjektit të rivlerësimit për kursimet dhe shpenzimet, në kushtet kur në vendimin e Komisionit mungon analiza financiare për periudhën 2010 – 2016. Ndërsa, lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, Komisioneri Publik parashtroi se duhet kërkuar nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar të shprehet lidhur me pasjen e kontakteve të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit.

14.1. Në të njëjtën seancë, subjekti i rivlerësimit kërkoi riçeljen e hetimit dhe marrjen e provave të reja, në funksion të ushtrimit të së drejtës së mbrojtjes përkundrejt pretendimeve të Komisionerit Publik, në përputhje me parimet e procesit të drejtë dhe të rregullt ligjor. Bashkëlidhur kërkesës, subjekti i rivlerësimit paraqiti 3 (tri) aktet e mëposhtme.

- 1) Përgjigje nga Enti Kombëtar i Banesave (në vijim “EKB”) znj. N.P.<sup>4</sup>. Sipas përmbajtjes, dosja e kërkuësës është e plotë dhe dokumentacioni në përputhje me kërkesat e VKM-së nr. 600/2007, që ka rregulluar miratimin e kredisë lehtësuese me 4% interes.
- 2) Akt ekspertimi financiar i të ardhurave dhe pasurisë së subjektit për vitet 2003-2016 nga një ekspert kontabël i autorizuar<sup>5</sup>. Sipas ekspertit, të ardhurat e përdorura për krijimin e pasurisë së paluajtshme, pasurisë së luajtshme dhe monetare, që zotëron në fund të vitit 2016, përbëjnë vetëm 23% të të ardhurave të përfituara nga subjekti dhe bashkëshortja në periudhën 2003 – 2016.
- 3) Shkresa përcjellëse [nr. {\*\*\*} prot., datë 05.12.2019] dhe vendimi i Prokurorit të Përgjithshëm [nr. {\*\*\*}, datë 22.11.2019] “Mbi arkivimin e kërkesë/ankesës, për përzgjedhjen dhe punësimin e shtetasit A.M. në Prokurorinë e Apelit Tiranë”<sup>6</sup>.

14.2. Në përgjigje të kërkesave të Komisionerit Publik dhe subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vendosi:

- a) të riçelë hetimin dhe të lejojë marrjen në cilësinë e provave të tri akteve të sjella nga subjekti i rivlerësimit;
- b) të marrë vendim për kryerjen e analizës financiare nga Kolegji, pasi të dëgjojë nga Komisioneri Publik qëndrimin e tij pas shqyrtimit të akteve të sjella nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e provës;
- c) të mos hetojë për një denoncim të datës 15.04.2019, dërguar në adresën elektronike të Komisionerit Publik, pasi denoncimi nuk përmban indicie për fakte në lidhje me kriteret e rivlerësimit siç përcaktohet nga neni 53, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

15. Në seancën gjyqësore të datës 14.09.2020, subjekti i rivlerësimit parashtroi shpjegimet e tij lidhur me faktet e pretenduara në denoncimet e paraqitura në Kolegj prej datës 03.04.2019<sup>7</sup> dhe paraqiti 10 (dhjetë) aktet e mëposhtme.

---

<sup>4</sup> Nr. {\*\*\*} prot., datë 25.02.2020, me lëndë “Kthim përgjigje”.

<sup>5</sup> Sipas ekspertizës, të ardhurat totale për periudhën 2003 – 2016 përlllogariten në vlerën 38.589.252 lekë, vlera totale e pasurive aktuale, të luajtshme, të paluajtshme, në datën 31.12.2016 përlllogaritet në shumën 13.206.673 lekë, kurse shpenzimet në vlerën 25.382.579 lekë.

<sup>6</sup> Në vendim pasqyrohet se Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), më datë 04.10.2019, i ka përcjellë Prokurorit të Përgjithshëm kërkesën/ankesën e Komisionit lidhur me transferimin e dosjes për inspektim të subjektit të rivlerësimit për rastin që lidhet me disa elemente të punësimit dhe lejes vjetore për z. A.M.. Prokurori i Përgjithshëm ka vendosur ta arkivojë kërkesën si të papranueshme për shkak të parashkrimit të afatit për hetimin disiplinor, mbështetur në nenet 120, pika 1, germa “b” dhe 121, pika 2, germa “a” e ligjit nr. 96/2016.

- 1) Formularë të listëprezencave të punonjësve (prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore, administratë) për periudhën 2014 – 2016, nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e drejtuesit.
- 2) Kopje të kërkesës për leje të z. A.M., me detyrë teknik i specialiteteve të ndryshme dhe magazinier.
- 3) Urdhri nr. {\*\*\*}, datë 06.07.2015, “Për miratimin e grafikut të lejeve vjetore për punonjësit e administratës së institucionit, për vitin 2015”, nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Tiranë.
- 4) Fletëhyrjet dhe fletëdaljet e magazinës për periudhën qershor – shtator 2015.
- 5) Shkresa përcjellëse e Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme dhe urdhri i Prokurorit të Përgjithshëm “Për transferimin e punonjësve të administratës” nr. {\*\*\*} [datë 27.01.2016], me lëndë “Për transferim punonjësi”, për transferimin e punonjësës A.D.
- 6) Shkresa me lëndë “Për transferim punonjësi”, e Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme, për transferimin e punonjësës R.M. [nr. {\*\*\*} prot. E.Z., datë 28.01.2016].
- 7) Shkresa me lëndë “Për transferim punonjësi”, e Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme, për transferimin e punonjësës D.N. [nr. {\*\*\*} prot. E.Z., datë 01.11.2016].
- 8) Vërtetim notash i Fakultetit të Drejtësisë së Universitetit të Tiranës për znj. A.D., datë 30.07.2018.
- 9) Kontrata individuale e punës mes punëdhënësit, subjektit të rivlerësimit, dhe punëmarrësit A.D., për pozicionin “K/Sekretare”, në Prokurorinë e Apelit Tiranë [nr. {\*\*\*} prot., datë 07.08.2018].
- 10) Vërtetim i gjendjes gjyqësore për z. L.B.K. [nr. {\*\*\*} prot., datë 06.07.2020].

**15.1.** Në të njëjtën seancë gjyqësore, Komisioneri Publik shprehu qëndrimin e tij lidhur me aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në seancën gjyqësore të datës 22.07.2020 dhe kërkoi kryerjen e një analize financiare për vitet 2003 – 2016.

**15.2.** Trupi gjykues vendosi të pranojë kërkesën e Komisionerit Publik dhe përcjelljen e kësaj analize paraprake palëve brenda 10 ditëve, për të mundësuar njohjen dhe paraqitjen me shkrim të pretendimeve përpara seancës së radhës, në funksion të efikasitetit të procesit gjyqësor<sup>8</sup>. Gjithashtu, trupi gjykues lejoi marrjen në cilësinë e provës të 10 (dhjetë) akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit.

**16.** Në seancën gjyqësore të datës 02.10.2020, për të provuar pretendimet e tij përkundër rezultateve të analizës financiare të kryer nga Kolegji<sup>9</sup>, subjekti i rivlerësimit paraqiti 16 (gjashtëmbëdhjetë) aktet e mëposhtme.

- 1) Analizë financiare në format *excel* dhe analizë përmbledhëse.
- 2) Shkresa me lëndë “Kthim përgjigjeje kërkesës për dokumentacion për udhëtime pune” nr. {\*\*\*} prot., datë 30.09.2020, nga Kryeministria drejtuar znj. N.P.<sup>10</sup>, shoqëruar me:

<sup>7</sup> Më datë 30.06.2020, Kolegji i përcolli subjektit të rivlerësimit: denoncimin anonim të datës 03.04.2019 [regjistruar me nr. {\*\*\*} prot.]; denoncimin nga z. K.P. më datë 12.04.2019 [regjistruar me nr. {\*\*\*} prot.]; dy denoncimet e përcjella nga Komisioneri Publik më datë 19.04.2019 [regjistruar me nr. {\*\*\*} prot.]; dy denoncime të përcjella nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit më datë 31.10.2019 dhe më datë 07.11.2019 [të regjistruar përkatësisht me nr. {\*\*\*} prot. dhe nr. {\*\*\*} prot.]; denoncimin e znj. M.B. më datë 06.11.2019 [regjistruar me nr. {\*\*\*} prot.]; denoncimin e z. N.Gj. më datë 06.12.2019 [regjistruar me nr. {\*\*\*} prot.].

<sup>8</sup> Më datë 30.09.2020, subjekti i rivlerësimit dërgoi në rrugë elektronike shpjegimet e tij për këtë analizë financiare. Materiali u regjistrua në Kolegj me nr. {\*\*\*} prot., datë 30.09.2020.

<sup>9</sup> Analiza financiare paraprake e kryer nga Kolegji iu dërgua subjektit të rivlerësimit dhe Institucionit të Komisionerëve Publikë [për dijeni ONM-së] me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 23.09.2020.

- i) notë verbale, datë 07.02.2006, drejtuar ambasadës franceze për pajisjen me vizë me qëllim pjesëmarrjeje në aktivitetin që do të zhvillohej në Strasburg në datat 26 shkurt deri më 3 mars 2007;
  - ii) notë verbale, datë 11.04.2006, drejtuar ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar për pajisjen me vizë, duke shprehur se qëndrimi përfshin datat 2.05.2006 – 13.05.2006;
  - iii) shkresë përcjellëse, datë 30.10.2006, drejtuar Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (në vijim “METE”), lidhur me caktimin e përfaqësuesit në seminarin që do të zhvillohej në datat 10 – 29 nëntor 2006<sup>11</sup>;
  - iv) notë verbale, datë 16.10.2007, drejtuar ambasadës së ShBA-së, për pajisjen me vizë të bashkëshortes dhe subjektit të rivlerësimit, duke shprehur se znj. P. do të marrë pjesë në kolokium në {\*\*\*} nga data 13 – 21 nëntor 2007;
  - v) shkresë përcjellëse drejtuar METE-s për pjesëmarrjen në seminarin që do të zhvillohej në Pekin, në datat 20.05.2008 – 03.06.2008;
  - vi) urdhër pagesë drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, në Kryeministri (maj 2008), lidhur me vizitën në datat 14-16 maj 2008, në Maqedoni<sup>12</sup>;
  - vii) urdhër pagesë drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, në Kryeministri, datë 7.11.2008, lidhur me vizitën në datat 09 – 15 nëntor 2008, në Gjermani<sup>13</sup>.
- 3) Vërtetim nr. {\*\*\*}, datë 01.10.2020, nga Agjencia Kombëtare Bërthamore<sup>14</sup>.
  - 4) *E-mail* nga znj. A.M.P., më datë 29.09.2020, i njësuar me origjinalin<sup>15</sup>.
  - 5) *E-mail* nga z. S.Sh.G., më datë 28.09.2020, i njësuar me origjinalin<sup>16</sup>.
  - 6) *E-mail* zyrtar me znj. E.Th., eksperte e Misionit Euralius [datë 27 dhe 29.03.2007] lidhur me një vizitë studimore në Kroaci në datat 24-27 prill 2007, i njësuar me origjinalin.
  - 7) Letër falënderimi për pjesëmarrjen nga znj. A.Th., datë 13.11.2007, me funksion specialiste e administratës pranë Qendrës për Studime Ndërkombëtare të asociuar me Universitetin e {\*\*\*} së Jugut [{\*\*\*}] ShBA. Bashkëngjitur këtij akti, subjekti paraqiti njoftimin dhe axhendën e aktivitetit, të njësuar me origjinalin.
  - 8) Vërtetim i datës 28.09.2020, për dy vizita studimore me projektin SMEI (në datat 24-28 qershor 2007 në Budapest, Hungari dhe në datat 10-14 tetor 2007 në Bruksel dhe Holandë [Hagë]), i njësuar me origjinalin.
  - 9) Certifikatë e pjesëmarrjes në programin ndërkombëtar të “Përkthimit të politikave në legjislacion”, të organizuar nga RIPA në datat 02-12 maj 2006, e njësuar me origjinalin.

<sup>10</sup> Sipas përmbajtjes së shkresës, janë vënë në dispozicion të kërkueses dokumentacioni lidhur me udhëtimet e punës të kryera prej saj jashtë shtetit për veprimtari të ndryshme, gjatë periudhës 2006 – 2008, kur ka punuar pranë këtij institucioni.

<sup>11</sup> Bashkëlidhur gjendet shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 20.10.2006, e METE-s, me lëndë “Njoftim për kurs trajnimi në Republikën Popullore të Kinës” dhe njoftimi nr. {\*\*\*}, datë 12.10.2006, i Ambasadës së Republikës Popullore të Kinës në RSh.

<sup>12</sup> Bashkëlidhur mandatpagesa për dieta, fletë udhëtimi për dietat, pajisje me vizë dhe llogaritjen e shpenzimeve të akomodimit, si dhe një memo informuese drejtuar kryeministrit, datë 13.05.2008, shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 12.05.2008, e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit lidhur me organizimin e vizitës, axhenda e takimeve për datat 14 dhe 15 maj 2008.

<sup>13</sup> Bashkëlidhur shënimi i datës 06.11.2008, fletë udhëtimi për dieta, e-mail-e për rezervimin e biletës dhe mandatpagesën për dieta.

<sup>14</sup> Sipas shkresës, znj. P. është paguar nga ky institucion me 5.850 lekë, për pjesëmarrje në grupin e punës të ngritur me urdhrin e datës 18.03.2013. Në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti është bashkëlidhur edhe një nxjerrje e llogarisë bankare lidhur me urdhërxhirimin e kësaj shume në datën 03.04.2013.

<sup>15</sup> Znj. P. deklaroi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë qëndruar në shtëpinë e saj në periudhën 18.8.2005 – 27.8.2005. Bashkëlidhur e-mail-it një kopje e faqes së pasaportës së saj.

<sup>16</sup> Z. G. deklaroi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë qëndruar në shtëpinë e tij në nëntor 2007 dhe sa herë kanë ardhur në USA. Bashkëlidhur e-mail-it, një kopje e faqes së pasaportës dhe e lejes së drejtimit të automjetit, lëshuar nga shteti i Nju Jorkut.



- 10) Certifikatë e pjesëmarrjes në programin e trajnimit për menaxhimin, në datat 10 – 29 nëntor 2006, në {\*\*\*}, në Republikën Popullore të Kinës, e njësuar me origjinalin.
- 11) Vërtetim të datës 23.08.2018, nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, me të ardhurat në vlerat bruto dhe neto për vitet 2001, 2013, 2006, 2010 dhe 2016, i njësuar me origjinalin për znj. N.P.
- 12) Fotokopje e pasaportës me vizat dhe hyrje-daljet në Republikën Popullore Socialiste të Kinës, për z. D.P., e njësuar me origjinalin.
- 13) Fotokopje e pasaportës me vizat dhe hyrje/daljet në Republikën Popullore Socialiste të Kinës dhe në ShBA, për z. Dritan Peka dhe znj. N.P., e njësuar me origjinalin.
- 14) Vërtetim të certifikatës së pjesëmarrjes në vizitën studimore të organizuar në Estoni në datat 29.09 – 3.10.2008, i njësuar me origjinalin.
- 15) Certifikatë për pjesëmarrje në seminarin e sponsorizuar nga Ministria e Tregtisë dhe qeveria kineze, për periudhën 20 maj – 3 qershor 2008, e njësuar me origjinalin.
- 16) Certifikatë për pjesëmarrje në seminarin e zhvilluar në datat 10 – 14 nëntor 2008, në Berlin (ReSPA), e njësuar me origjinalin.

**16.1.** Në përfundim të kësaj seance gjyqësore, trupi gjykues vendosi t'i pranojë aktet e sipërcituara në cilësinë e provës dhe pas deklarimit të palëve për mospasje të kërkesave shtesë, vendosi mbylljen e hetimit gjyqësor dhe ftoi palët të paraqesin konkluzionet përfundimtare.

17. Në seancën gjyqësore të datës 08.10.2020, palët prezantuan konkluzionet përfundimtare. Konkretisht:

**17.1.** Komisioneri Publik parashtrroi se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, në kuptim të neneve 61, pika 3 dhe 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Në vlerësimin e Komisionerit Publik:

i.) lidhur me kredinë me kushte lehtësuese, gjatë shqyrtimit gjyqësor u arrit të provohej se *aplikimi* është konform kërkesave të VKM-së nr. 600/2007, lidhur me kategorinë e subjekteve përfituese për shkak të pozicionit të barasvlershëm të znj. P., me atë të drejtorit;

ii.) për periudhën 2003 – 2016, subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme pasuritë e krijuara, kursimet *cash* të deklaruara dhe shpenzimet e kryera. Për këtë çështje, Komisioneri Publik shprehu qëndrimin se:

- referuar vitit 2005, që rezultoi me diferencë negative, por jo vetëm, në vitet ku analiza financiare rezulton me balancë negative apo me mungesë burimesh nga të ardhura të ligjshme, kursimet *cash* të deklaruara nga subjekti që gjenden jashtë sistemit bankar, nuk mund të konsiderohen si burim të ardhurash të ligjshme dhe të shërbejnë në vitet në vazhdim;
- në analizën financiare të vitit 2010 duhet të përfshihen likuiditetet *cash* të deklaruara nga subjekti sipas deklarimeve të tij në deklaratën e interesave privatë për këtë vit;
- gjendja e likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar duhet të përllorarit bazuar në deklaratimet e kryera nga subjekti në deklaratat e interesave privatë/periodikë vjetorë, mbështetur edhe në jurisprudencën e krijuar për trajtimin e likuiditeteve *cash* nga Kolegji<sup>17</sup>, gjatë procesit të rivlerësimit.

iii.) Lidhur me rastet e përmendura në ankim për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioneri Publik vlerësoi se rezultuan bindëse çështjet si vijojnë.

- Procedura e përzgjedhjes, punësimit dhe kohëzgjatjes së lejes së paguar të z. A.M., transferuar për inspektim pranë organit kompetent, referuar pikës 2 të vendimit nr. 112/2019. Në lidhje me këtë çështje, Komisioneri Publik u shpreh se [...] *gjatë*

<sup>17</sup> Vendimet (JR) nr. 11/2019, në prg. 27; (JR) nr. 19/2019, në prg. 84; (JR) nr. 20/2019, në prg. 59; (JR) nr. 7/2019, në prg. 39.

*gjykimit, u provua se çështja është arkivuar nga organi kompetent, Prokuroria e Përgjithshme, [...] por nuk u provua nëse Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi kushtetues që ka në përgjegjësi marrjen e masave disiplinore ndaj prokurorëve të të gjitha niveleve, ka disponuar më tej lidhur me këtë vendim [...].*

- Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me procedurat e brendshme për paraqitjen e rekursit, lidhur me denoncimin e familjes P. Ndërsa, për sa u përket hapave të ndërmarrë prej tij për këtë shkelje të kryer nga prokurori i apelit, nuk pati sqarime nga ana e subjektit.
- Shpjegimi i subjektit të rivlerësimit për denoncimin anonim – sa i përket tërheqjes nga ankimi për të pandehurin N.P., se ndryshimet në legjislacionin procedural penal, sipas të cilit prokurori në gjykim është i pavarur dhe nuk i diskuton qëndrimet e tij për çështje konkrete me prokurorin më të lartë.

**17.1.1.** Në përfundim, Komisioneri Publik kërkoi që shkaqet e parashtuara në ankim të merren në konsideratë dhe, në bazë të nenit 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, Kolegji të vendosë ndryshimin e vendimit të Komisionit nr. 112, datë 4.3.2019 dhe shkarkimin nga detyra të subjektit e rivlerësimit. Për sa i përket shkakut të ankimit që i përket përdorimit të kredisë me kushte lehtësuese me destinacion të ndryshëm nga ai i përfitimit, Komisioneri Publik, në fjalën përfundimtare, u shpreh se për rëndësi vendimtare të mënyrës së përfitimit<sup>18</sup> dhe përfundimisht e linte në vlerësim të gjykatës këtë element të shkaqeve të ankimit fillestar.

**17.1.2.** Në konkluzionet përfundimtare me shkrim, Komisioneri Publik parashtroi se u përmbahej të gjitha shkaqeve të ankimit<sup>19</sup>, ndërsa gjatë shtjellimit të detajuar të tyre, kërkimi për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit i referohej vetëm njërit prej elementeve që përbënin shkaqet e ankimit të kriterit të vlerësimit të pasurisë, ndërsa për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, zgjodhi të mos sillte kërkesë [shih edhe paragrafin 17.1.iii.] Trupi gjyqësor, duke marrë në konsideratë shpjegimet e dhëna nga Komisioneri Publik gjatë seancës, mbi mënyrën se si konceptohen nga ana e tij konkluzionet përfundimtare<sup>20</sup>, vendosi t’i trajtojë të gjitha parashtrimet si pjesë integrale dhe të lidhura me njëra-tjetrën.

**17.2.** Subjekti i rivlerësimit, pasi parashtroi qëndrimin e tij përkundrejt shkaqeve të ankimit fillestar të Komisionerit Publik, u shpreh se nuk ka rezultuar të ketë deklaruar më shumë se dyfishin e pasurisë, nuk ka probleme serioze me kontrollin e figurës, nuk rezulton të ketë bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriteret e kontrollit të figurës dhe të pasurisë dhe është i përshtatshëm nga ana e vlerësimit të aftësive profesionale. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Komisionit, duke konfirmuar qëndrimin e tij në detyrë.

<sup>18</sup> Shih faqen 9 të ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit të Komisionit për këtë element, në analizë të rrethanave të “[...] aplikimit, përfitimit dhe përdorimit [...]”, paragrafi 12.10.

<sup>19</sup> Shih paragrafin nr. 8 të konkluzioneve përfundimtare të Komisionerit Publik, faqja 9: “[...] kërkojmë që shkaqet e parashtuara në ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit [...]”, pasqyruar edhe në: <http://ikp.al/wp-content/uploads/2019/04/Parashtrimet-e-%C3%A7%C3%ABshtjes-dat%C3%AB-8.10.2020.pdf>.

<sup>20</sup> Pyetur nga relatorja të shpjegonte paragrafin nr. 8 të fjalës përfundimtare dhe paragrafin nr. 11 të ankimit fillestar (faqe 6), lidhur me pretendimin për deklaram të pasaktë nga ana e subjektit të rivlerësimit për sa i përket deklaramit të pasaktë në lidhje me pasurinë dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, Komisioneri Publik u shpreh se: “[...] Sikurse deklarova, unë u qëndroj të gjithave. Këtu ne dhamë konkluzionet përfundimtare duke i përmbledhur të gjitha, duke mos i shkuar në detaje sepse do të zgjatëshim shumë. Prandaj dhe ne përmbledhëm aq sa mundëm të përmbledhnin konkluzionet përfundimtare [...]”. Nga ana tjetër, pyetur sa i përket shkakut të ankimit fillestar, faqja 15, paragrafi nr. 16, për analizimin e denoncimeve në kuadër të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioneri Publik u shpreh se: “[...] Edhe ne i qëndrojmë faqes 9 të konkluzioneve përfundimtare, të tjerat janë irelevante dhe prandaj ne nuk kemi mbajtur qëndrim në konkluzionet përfundimtare [...]”.

*C. Vlerësimi nga trupi gjykues i shkakut të ankimit që lidhet me kriterin e vlerësimit të pasurisë*

- 18 Komisioneri Publik pretendon se, referuar analizës financiare për periudhën 2003 – 2016, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm në kuptim të neneve 61, pika 3, dhe 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Sipas Komisionerit Publik, nga analiza tërësore e deklaratave të interesave pasurorë privatë/vjetorë, dorëzuar në ILDKPKI, përfshirë deklaratën *vetting*, duke marrë në konsideratë dhe mungesën e analizës së plotë financiare nga Komisioni për periudhën 2010 – 2016, subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme pasuritë e krijuara, kursimet e deklaruara dhe shpenzimet e kryera, për afërsisht në shumën 3,6 milionë lekë<sup>21</sup>.

18.1. Gjithashtu, Komisioneri Publik parashtron se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ mbi gjendjen e likuiditetit *cash*, nuk përputhen me ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratat e interesave privatë të vitit përkatës deklarues. Sipas Komisionerit Publik, shpjegimet dhe pretendimet e subjektit mbi likuiditetet *cash* mbeten në nivel deklarativ. Për këtë arsye, analiza e kryer prej këtij institucioni është bazuar vetëm në deklaratimet e subjektit në deklaratat e interesave privatë, të depozituara pranë ILDKPKI-së. Komisioneri Publik arsyeton se, bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003”), si dhe në rubrikën e deklaratës së interesave pasurorë privatë/vjetorë, “Ndryshimi i pasurive dhe burimi i krijimit”, me sqarimet përkatëse, subjekti ka pasur detyrim të deklarojë shtesat dhe pakësimet e vitit deklarues.

18.2. Në analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitet 2005, 2006 dhe 2009, fillimisht sipas rezultateve të hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit rezultoi se kishte mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera, në vlerën totale prej 896.801 lekësh<sup>22</sup>. Pas shpjegimeve dhe provave të sjella nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës, Komisioni rishikoi analizën financiare dhe konkludoi në vendim se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve financiare për të përballuar njëkohësisht investimet dhe shpenzimet e kryera dhe realizimin e kursimeve të deklaruara në vitet 2005, 2006 dhe 2009, në vlerën totale prej 411.588 lekësh<sup>23</sup>.

18.3. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se ndër vite subjekti i rivlerësimit ka deklaruar likuiditete në gjendje *cash* në deklaratat e interesave privatë për gjithë vitet, përjashtuar 2003, 2004, 2015, 2016 dhe në deklaratën *vetting*. Konkretisht, nga deklaratimet rezultojnë sa vijon.

---

<sup>21</sup> Sipas Komisionerit Publik, totali prej 3,6 milionë lekësh balancë negative përbëhet nga balancat negative mes të ardhurave dhe shpenzimeve ndër vite, si vijon: për vitin 2005, subjekti i rivlerësimit rezultojnë me pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme për të mbuluar shumën prej – 80.225 lekësh; për vitin 2006, për shumën prej – 768.641 lekësh; për vitin 2010, për shumën prej –285.021 lekësh; për vitin 2013, për shumën prej – 480.618 lekësh; për vitin 2014, për shumën prej -310.268 lekësh; për vitin 2015, për shumën prej - 394.317 lekësh, dhe për vitin 2016, shumën prej -1.290.543 lekësh. Ky rezultat financiar është përlogaritur mbi bazën e shpenzimeve të jetesës në totalin e përlogaritur nga ILDKPKI-ja, dhe të përpjesëtuar për periudhën hetimore, shpenzimet e udhëtimit jashtë shtetit, bazuar në deklaratimet e subjektit, dokumentacionin e paraqitur për udhëtimet për jashtë shtetit dhe biletat e udhëtimit, referuar çmimeve të biletave që kompanitë ajrore kanë publikuar dhe shpenzime të tjera, sipas pyetësorëve të hetimit e shpenzimeve të kryera nëpërmjet llogarive bankare. Shih faqen 5 të parashtrimeve të datës 22.07.2020, pasqyruar edhe në:

<http://ikp.al/wp-content/uploads/2019/04/Parashtrimet-e-%C3%A7%C3%ABshtjes-dat%C3%AB-22.7.2020.pdf>

<sup>22</sup> Përkatësisht sipas viteve: në vitin 2005 – balancë negative në vlerën 492.977 lekë; në vitin 2006 – balancë negative në vlerën 213.112 lekë dhe në vitin 2009 – balancë negative në vlerën 190.711 lekë.

<sup>23</sup> Përkatësisht sipas viteve: në vitin 2005 – balancë negative në vlerën 132.977 lekë, në vitin 2006 – balancë negative në vitin 207.924 lekë dhe në vitin 2009 – balancë negative në vlerën 70.687 lekë.

- Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Gjendje *cash* – 500.000 lekë”<sup>24</sup>.
- Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Gjendje para – *cash* – 4000 €”<sup>25</sup>.
- Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Para të kursyera gjendje *cash* – 350000 lekë”.
- Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Para të kursyera – *cash* – 600.000 lekë”.
- Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Para të kursyera – *cash* – 900.000 lekë”.
- Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Para të kursyera – *cash* nga paga – 1.000.000 lekë; Para të kursyera – *cash* nga kredia të “BKT” – 1.500.000 lekë”. Po në këtë deklaratë, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Shlyerje e kredisë në datën 11.6.2010, në bankën “NBG”, *cash* me para të kursyera [...]”.
- Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Para të kursyera – *cash* nga paga – 1.300.000 lekë”.
- Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Para të kursyera – *cash* – 1.600.000 lekë”.
- Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Para të kursyera – *cash* – 600.000 lekë”.
- Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Para të kursyera – *cash* – 900.000”.

**18.4.** Gjatë hetimit administrativ në Komision, nëpërmjet pyetësorëve, lidhur me gjendjen e likuiditeteve *cash* në fund të çdo viti për periudhën 2003 – 2016, në përgjigjen e pyetësorit të datës 24.08.2018, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar:

“[...] ne kemi deklaruar për çdo vit konsumin dhe kursimin e atij viti, sipas deklaratave periodike vjetore. Kjo, për shkak se në deklarimet e mia vjetore kam pasqyruar shpenzimet e zakonshme dhe të ardhurat e atij viti deklarimi, për të pasqyruar ndryshimet e atij viti. Pra, në logjikën time kam dashur të pasqyroj ndryshimet e atij viti. Ndërkohë që kam bërë shpenzime nga *cash*-i i akumuluar vitet e mëparshme, për arsye të ndryshme, si: arredim shtëpie, blerje makine apo udhëtime. Për këtë arsye, gjendja e likuiditeteve të akumuluar *cash*, nuk ka pasqyruar gjendjen reale në fund të çdo viti [...]”.

**18.4.i** Më tej, në pyetësor, subjekti ka deklaruar likuiditete si *gjendje*, qasje që ndryshon nga mënyra si subjekti ka deklaruar sipas ligjit nr. 9049/2003 ndër vite, duke filluar nga viti 2007. Më konkretisht, teksa për periudhën 2003-2007, periudhë që përkon me vitet e para të deklarimit, subjekti rezulton të ketë ndjekur qasjen e deklarimit të *gjendjes*, si edhe specifikohet në ligj<sup>26</sup>, vlerat e deklaruara në pyetësor ndryshojnë edhe në vlerë me *gjendjet* e deklaruara për vitet 2005 dhe 2006 nga ai vetë në zbatim të ligjit 9049/2003. Konkretisht, ndërsa në pyetësorin e datës 24.08.2018 subjekti ka deklaruar respektivisht: “*Gjendja e likuiditeteve cash në banesë në fund të vitit 2005, 860.000 lekë [...] dhe “Gjendja e*

<sup>24</sup> Faqja 3 e formularit, pjesë organike e ligjit nr. 9049/2003, i dedikohet pasqyrimin të shtesave dhe ndryshimeve duke udhëzuar subjektet deklaruese të shprehën për shtesa dhe pakësime nga “deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit.” Shih edhe paragrafin 19.4.iii.

<sup>25</sup> Konvertuar në vlerën 495.400 lekë, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, të datës 31.12.2006 (1 euro = 123,85 lekë):

[https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi\\_zyrtar\\_i\\_kembimit/Arkiva\\_e\\_kursit\\_te\\_kembimit/](https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_kembimit/Arkiva_e_kursit_te_kembimit/).

<sup>26</sup> Shih paragrafin 18.3 më sipër dhe poshtëshënimin nr. 29.

*likuiditeteve cash në banesë në fund të vitit 2006, 860.000 lekë. [...]”*, në deklaratat periodike të viteve 2005 dhe 2006 subjekti ka deklaruar 500.000 lekë dhe 4.000 euro respektivisht. Në pyetësor, subjekti shprehet për gjendje të likuiditeteve *cash* për vitet e tjera, gjendje, si vijon:

- 2007, *përafërsisht 1.200.000 lekë [...]*.
- 2008, *përafërsisht 1.800.000 lekë [...]*.
- 2009, *rreth 2.700.000 lekë [...]*. 2010, *rreth 2.500.000 lekë [...]*. *Shuma e kursyer ndër vite deri në 2009, ka shërbyer për blerjen e kredisë të NBG Bank në vlerën e përafërt 2.650.000 lekë [...]*.
- 2011, *rreth 3.500.000 lekë [...]*.
- 2012, *rreth 3.400.000 lekë [...]*.
- 2013, *rreth 3.400.000 lekë [...]*.
- 2014, *rreth 3.700.000 lekë [...]*.
- 2015, *rreth 2.900.000 lekë [...]*.
- 2016, *rreth 1.500.000 lekë [...]*.
- 2017, *rreth 1.100.000 lekë [...]*.

**18.4.ii.** Në pyetësorin e datës 21.12.2018, subjektit i është kërkuar të shpjegonte mosdeklarimin e gjendjeve dhe shpenzimeve në vitet 2015 dhe 2016 dhe në deklaratën *vetting*, referuar pyetësorit të mësipërm mbi gjendjen e *cash*-it në banesë [2,9 milionë lekë në fund të vitit 2015 dhe 1,5 milionë lekë në fund të vitit 2016], sikurse nuk janë deklaruar as shpenzime të cilat do të shkonin në vlerën prej 1,4 milionë lekësh apo nuk është deklaruar *cash* jashtë sistemit bankar në fund të vitit 2016. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar<sup>27</sup> se në deklaratën për vitin 2016 dhe atë *vetting* gjendja e *cash*-it në banesë është deklaruar zero, pasi nuk ka kursyer nga të ardhurat e vitit 2016 dhe ka pasur shpenzime të deklaruara në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016. Duke iu referuar pyetësorit të datës 24.08.2018, subjekti është shprehur se gjendja e likuiditeteve *cash* në banesë në fund të vitit 2015, ka qenë rreth 2.900.000 lekë, kurse në fund të vitit 2016, rreth 1.500.000 lekë, nga të cilat 1.400.000 lekë janë shpenzuar për të përballuar shpenzimet e bëra gjatë vitit 2016, së bashku me të ardhurat e tjera, sipas deklaratës vjetore. Më tej, subjekti ka pretenduar se për sa u përket shpenzimeve të vitit 2016, në deklaratën periodike vjetore: “[...] kam deklaruar shpenzimet përkatëse mbi 300.000 lekë. [...] Në pyetësorin e datës 24.08.2018, kam deklaruar sipas pyetjes suaj edhe shpenzime për udhëtime, për vitin 2016 [...]”.

19. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të zhvilluar në Kolegj, në përgjigje të kërkesës së Komisionerit Publik (shtjelluar në paragrafin 15.2.), u vendos në dispozicion të palëve analiza financiare paraprake e kryer nga Kolegji për periudhën 2003 – 2016. Sipas kësaj analize, subjekti i rivlerësimit rezultoi me pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme për të mbuluar shpenzimet për disa vite, me vlerë totale negative prej 3.802.788 lekësh, përkatësisht në vitet 2005, 2006, 2007, 2012, 2013, 2015 dhe 2016<sup>28</sup>.

**19.1.** Në analizën financiare paraprake të kryer nga Kolegji, u morën në konsideratë:

a) *vlera e pasurive neto të subjektit të rivlerësimit*, e përbërë nga vlerat e pasurive të paluajtshme apo të luajtshme ndër vite, referuar kontratave të shitblerjeve; vlerat e kredive sipas kontratave përkatëse; vlerat e shitjeve të automjeteve, sipas përcaktimeve në kontratat e shitjeve. Huaja e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në shumën prej 15.000 eurosh, e marrë

<sup>27</sup> Regjistruar në Komision me nr. {\*\*\*}, datë 03.01.2019.

<sup>28</sup> Subjekti i rivlerësimit rezultoi me pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme për të mbuluar shpenzimet, pasuritë dhe kursimet. Për secilin vit, rezultoi si vijon: për vitin 2005 – në shumën prej 133.601 lekësh; për vitin 2006 – në shumën prej 876.293 lekësh; për vitin 2007 – në shumën prej 1.189.856 lekësh; për vitin 2012 – në shumën prej 5.793 lekësh; për vitin 2013 – në shumën prej 66.664 lekësh; për vitin 2015 – në shumën prej 422.278 lekësh; për vitin 2016 – në shumën prej 1.108.304 lekësh.

në vitin 2010 nga z. E.T., nuk ndikon në rezultatin financiar të vitit 2010 pasi nuk është dokumentuar as marrja dhe as kthimi brenda vitit 2010;

b) të ardhurat nga pagat për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshorten e tij, sipas konfirmimeve nga vërtetimet e institucioneve përkatëse dhe të ardhurat nga interesat e depozitave, të ekstraktuara nga lëvizjet e llogarive dhe depozitave në zotërim të subjektit të rivlerësimit dhe/ose personit të lidhur me të, të konfirmuara nga bankat e nivelit të dytë;

c) shpenzimet, sikurse shpenzimet e jetesës, të përlllogaritura sipas metodologjisë të konfirmuar nga INSTAT-i ndër vite, përcjellë nga ILDKPKI-ja më datë 04.03.2019<sup>29</sup>. Në përlllogaritjen në Kolegj, janë vendosur shpenzimet e jetesës sipas numrit të anëtarëve të familjes në kohë të ndryshme; shpenzimet e mobilimit dhe shpenzimet e riparimit të automjetit sipas deklaratave të subjektit të rivlerësimit nga përgjigjet e pyetësorëve – në mungesë të akteve shkresore për dokumentimin e tyre apo të deklaratimit të tyre ndër vite sipas ligjit nr. 9049/2003 në deklaratat periodike vjetore; shpenzimet e shkollimit, nga faturat e administruara në dosje; shpenzimet e udhëtimeve, sipas informacionit mbi udhëtimet të nxjerra nga sistemi TIMS, të përlllogaritura sipas metodologjisë të përcaktuar në Kolegj<sup>30</sup> për vitet 2005-2011, ndërsa për vitet 2012-2016 sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorëve në kombinim me të dhënat e sistemit TIMS; shpenzimet për pagesa kredie janë evidentuar nga lëvizjet e llogarive të kredive për secilin vit, të konfirmuara nga Bankat NBG apo Banka Kombëtare Tregtare (në vijim “BKT”), referuar nxjerrjes së llogarive bankare;

ç) gjendja e llogarive bankare në fillim dhe në fund të vitit, sipas totalit të balancave të të gjitha llogarive/depozitave të subjektit ose personave të lidhur, në lekë ose në valutë të ekuivalentuar me kursin e datës 31 dhjetor të çdo viti, referuar konfirmimeve bankare;

d) gjendja e likuiditeteve cash në fillim dhe në fund të vitit, sipas vlerave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat e interesave privatë për vitet respektive.

**19.2.** Palët parashtruan qëndrimet e tyre mbi rezultatet e analizës financiare paraprahe të kryer nga Kolegji në seancën e radhës, më datë 02.10.2020.

**19.2.i** Komisioneri Publik u shpreh se analiza financiare e kryer nga Kolegji plotëson kërkesën e tij, pasi përfshin analizën e mbulimit me burime nga të ardhura të ligjshme të shpenzimeve dhe të investimeve të kryera në pasuri të luajtshme, të paluajtshme dhe likuiditete (*cash* dhe në bankë) të krijuara për periudhën e hetimit 2003 – 2016. Po ashtu, Komisioneri Publik shprehu dakordësinë me vlerat dhe zërat që u përkisnin pasurive neto, të ardhurave, shpenzimeve të mobilimit, shpenzimeve të jetesës, shpenzimeve për udhëtime jashtë shtetit dhe pagesat e kredive në NBG Bank e BKT, dhe me pasqyrimin e gjendjeve të llogarive bankare në fillim dhe në fund të vitit.

**19.2.ii.** Së fundmi, Komisioneri Publik vlerësoi që në vitet ku analiza financiare rezultoi negative – nuk mbulohen me të ardhura të ligjshme kursimet, investimet dhe shpenzimet e deklaruara apo të dokumentuara – kursimet *cash* të deklaruara jashtë sistemit bankar nuk mund të konsiderohen si burim të ardhurash të ligjshme për vitet në vazhdim. Në zbatim të këtij parimi, në analizën financiare për vitin 2005, e cila rezultonte me diferencë negative (në vlerën 133601 lekë), Komisioneri Publik vlerësoi që vlera prej 500000 lekësh *cash* e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, që gjendet jashtë sistemit bankar, krijimi i së cilës nuk justifikohet nga burime me të ardhura të ligjshme në vitin deklarues, të mos mbartet në vitin pasardhës apo si burim të ardhurash e shpenzimesh për vitin pasardhës e në vijim.

<sup>29</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot.

<sup>30</sup> Shih faqen 26 e në vijim të vendimit nr. 11/2019 - <http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/07/E-Islamaj-vendim-i-anonimizuar-p%C3%ABr-web.pdf>

**19.2.iii.** Lidhur me analizën financiare për vitin 2010, e cila rezultonte me diferencë pozitive (në vlerën 466.503 lekë), Komisioneri Publik konstatoi se në gjendjen e likuiditeteve të kursyera, duhet të përfshihej shuma prej 2.500.000 lekësh, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë për vitin përkatës.

**19.3.** Nga ana tjetër, subjekti i rivlerësimit parashtrroi se konstatimi i Kolegjit për bilanc negativ në vitet 2005, 2006, 2007, 2012, 2013, 2015 dhe 2016 është i pabazuar dhe rrjedh si pasojë e metodologjisë së ndjekur ndër vite nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe mënyrës së deklarimit në deklaratat e interesave privatë periodikë, ku lidhur me gjendjen e likuiditeteve *cash* në fund të çdo viti, është deklaruar çdo vit *konsumi* dhe *kursimi* i atij viti. Subjekti shtoi se në deklaratimet vjetore ka pasqyruar shpenzimet dhe të ardhurat “për të pasqyruar ndryshimet e atij viti” dhe që gjendja e likuiditeteve të akumuluar *cash* “nuk ka pasqyruar gjendjen reale në fund të çdo viti”. Sipas subjektit të rivlerësimit, shpenzimet janë të justifikuara me burime financiare të ligjshme dhe se nuk ka mungesë të burimeve financiare. Për të provuar pretendimet e tij, subjekti i rivlerësimit paraqiti 16 akte (të listuara në paragrafin 16) dhe parashtrroi në mënyrë të përmbledhur se:

**19.3.i.** Në analizën financiare për vitin 2005, depozita prej 3.000 dollarësh amerikanë, në emër të bashkëshortes, është mbyllur më datë 31.12.2004 dhe këto të ardhura janë konsumuar në periudhat më pas, duke rritur gjendjen *cash* në fillim të vitit 2005.

**19.3.ii.** Në dokumentacionin e administruar në fashikull lidhur me të ardhurat nga pagat, ka të ardhura të gjeneruara nga marrëdhëniet e punës dhe disa komponentë të strukturës së pagës (të tilla si: shpërblime, honorare etj.), disa vlera nga të cilat nuk rezultojnë të jenë përlllogaritur.

**19.3.iii.** Lidhur me shpenzimet e udhëtimit, subjekti i rivlerësimit kërkoi rishikimin e vlerës së përlllogaritur, pasi:

- në vitin 2005, udhëtimi është kryer te motra e tij në Bruksel dhe nuk ka pasur shpenzime për akomodim dhe ushqim;

- në vitin 2006, nga 6 udhëtimet e kryera, 2 udhëtime janë kryer nga bashkëshortja, të lidhura me pozicionin e punës, dhe se shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe ushqimit janë mbuluar në një rast nga Banka Botërore dhe në rastin tjetër nga qeveria kineze – përkatësisht në datat: 01.05.2006 – 13.05.2006 dhe 08.11.2006 dhe 29.11.2006, në Kinë<sup>31</sup>, kurse për udhëtimin e kryer në periudhën 04.09.2006 – 29.09.2006, në Kinë, nuk ka pasur shpenzime për akomodim dhe ushqim<sup>32</sup>; pjesa tjetër e udhëtimeve janë një-, dy- apo treditore dhe kanë qenë me kosto minimale shpenzimi;

- në vitin 2007, nga 12 udhëtime të kryera, 5 udhëtime janë kryer nga bashkëshortja, të lidhura me pozicionin e punës<sup>33</sup>. Sa u përket udhëtimeve në Kinë, në periudhën 12.07.2007 – 21.07.2007 dhe periudhën 04.09.2007 – 27.09.2007, nuk kanë përballuar shpenzime udhëtimit, akomodimi dhe ushqimi, pasi i ati i subjektit ka paguar biletat dhe kanë qëndruar te shtëpia e prindërve. Për udhëtimin në periudhën 07.08.2007 – 17.08.2007, në Turqi dhe në periudhën 11.05.2007 – 14.05.2007, në Republikën Çeke janë shfrytëzuar ofertat nga operatorët turistikë dhe shpenzimet kanë qenë minimale; ndërsa pjesa tjetër e udhëtimeve janë një-, dy- apo treditore dhe kanë pasur kosto minimale shpenzimi.

---

<sup>31</sup> Gjithë shpenzimet e udhëtimit për djalin, përfshirë edhe akomodimin, pretendoi subjekti, janë mbuluar nga prindërit e tij. Babai i subjektit në atë periudhë ka qenë Ambasador i Plotfuqishëm dhe Fuqplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën Popullore Socialiste të Kinës.

<sup>32</sup> Shih më sipër. Po ashtu, gjatë këtij udhëtimit, akomoduar te prindërit e subjektit të rivlerësimit dhe biletat mbuluar nga prindërit, pretendoi subjekti.

<sup>33</sup> Sipas subjektit, shpenzimet për vitin 2007 janë mbuluar për bashkëshorten respektivisht, nga Këshilli i Evropës, nga Misioni Euralius dhe fondet e projektit SMEI. Për udhëtimin në ShBA, subjekti pretendoi që lidhej me punën.

**19.3.iv.** Lidhur me gjenden e likuiditeteve *cash* të pasqyruar në analizën financiare për vitet 2015-2016 (në vlerën 5.181.642 lekë), subjekti parashtroi se në ndryshim nga vitet paraardhëse, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, në deklaratat e interesave privatë nuk ka deklaruar gjendje të likuiditeteve *cash* të kursyera në banesë, pasi të ardhurat nga pagat janë lënë pjesërisht në bankë dhe shpenzimet janë përballuar nga gjendja e *cash*-it të akumuluar në banesë. Sipas subjektit, gjendja e likuiditeteve *cash* në fillim dhe në fund të vitit, e pasqyruar në analizën financiare të Kolegjit, nuk është reale. Një pjesë e shpenzimeve të kryera në vitin 2015, parashtroi subjekti i rivlerësimit, janë mbuluar nga ndryshimi i *cash*-it të akumuluar në banesë. Në fund të vitit 2016, kursimet janë ulur përafërsisht në vlerën e pagesës së kredisë dhe kanë mbetur në nivelin rreth 1.500.000 lekë, sikundër ka deklaruar në vijimësi. Në analizën financiare të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit (prova nr. 1), vlera e *gjendjes së likuiditeteve cash* në fund të çdo viti, paraqitet si vijon:

- në vitin 2004, në vlerën prej 283.740 lekësh;
- në vitin 2005, në vlerën prej 500.000 lekësh;
- në vitin 2006, në vlerën prej 495.400 lekësh;
- në vitin 2007, në vlerën prej 350.000 lekësh;
- në vitin 2008, në vlerën prej 950.000 lekësh;
- në vitin 2009, në vlerën prej 1.850.000 lekësh;
- në vitin 2010, në vlerën prej 1.686.242 lekësh;
- në vitin 2011, në vlerën prej 2.986.242 lekësh;
- në vitin 2012, në vlerën prej 3.186.242 lekësh;
- në vitin 2013, në vlerën prej 3.786.242 lekësh;
- në vitin 2014, në vlerën prej 3.700.000 lekësh;
- në vitin 2015, në vlerën prej 2.900.000 lekësh;
- në vitin 2016, në vlerën prej 1.500.000 lekësh.

**19.3.v.** Subjekti i rivlerësimit parashton se totali i të ardhurave të tij dhe bashkëshortes nga paga dhe të tjera, për periudhën 1997 – 2016, është në vlerën 37.500.514 lekë dhe i rezulton një tepriçë pozitive në vlerën 7.300.588 lekë, të cilat kanë shërbyer për të mbuluar shpenzimet e familjes gjatë kësaj periudhe dhe, për rrjedhojë, nuk ka pamjaftueshmëri të ardhurash, qoftë për të mbuluar investimet në pasuri të paluajtshme, ashtu edhe për të përballuar shpenzimet.

**19.4.** Pasi shqyrtoi qëndrimin e Komisionerit Publik mbi analizën financiare të kryer në Kolegj dhe mbi provat e shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në dy seancat gjyqësore [të datës 22.07.2020 dhe 02.10.2020] mbi gjendjen financiare të tij ndër vite, si dhe dokumentacionin e administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit është i pasaktë në deklarimin e gjendjes së likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar. Nga dokumentacioni në fashikull dhe parashtrimet e tij, rezulton që në momente të ndryshme, subjekti deklaroi vlera të ndryshme të kursimeve jashtë sistemit bankar, të ndryshme edhe nga deklaratat periodike vjetore të kryera prej tij dhe personit të lidhur ndër vite, në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, dhe më pas në deklaratën *vetting*<sup>34</sup>.

**19.4.i.** Gjatë procesit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ishte kontradiktor edhe në analizat financiare të paraqitura përkatësisht në seancat e datave 22.07.2020 dhe 02.10.2020 [pas analizës paraprake të kryer nga Kolegji], kundrejt njëra-tjetrës, kundrejt vlerave të pretenduara prej tij në pyetësinë e datës 24.08.2018 si të kursyera, por edhe në raport me deklaratat periodike vjetore apo edhe deklaratën *vetting*. Konkretisht, në aktin e ekspertimit financiar të paraqitur në seancën gjyqësore të datës 22.07.2020, subjekti i rivlerësimit deklaroi gjendje *cash* (kursime) në datën 31.12.2016 jashtë sistemit bankar në vlerën

<sup>34</sup> Të listuara në paragrafin 18.3.



1.500.000 lekë (paragrafi 1.4., germa “f”, faqe 3), teksa kjo vlerë nuk rezulton të jetë e pasqyruar në tabelën shoqëruese, në të cilën pasqyrohen të ardhurat, shpenzimet dhe kursimet për secilin vit për periudhën 2003 – 2016, dhe shumatorja përfundimtare. Përveç kësaj mospërputhjeje, në analizën financiare kursimet janë evidentuar si diferencë e të ardhurave dhe shpenzimeve, ndërsa shtesat vjetore në llogaritë përkatëse bankare apo likuiditetet *cash* jashtë sistemit bankar, të deklaruara ndër vite apo në procesin gjyqësor, nuk janë treguar në vlerë apo sasi si zë i veçantë, që bie ndesh me detyrimin e subjektit të rivlerësimit për deklarim të plotë e të saktë në funksion të kontrollit të kriterit pasuror nga ana e trupit gjykues të Kolegjit. Së fundmi, në analizën financiare të paraqitur në seancën gjyqësore të datës 02.10.2020, gjendja e likuiditeteve *cash* në fund të vitit nuk përputhet me atë të deklaruar në përgjigjet e pyetësorit të datës 24.08.2018 apo me vlerat e deklaruara prej tij në pyetësorin e datës 21.12.2018<sup>35</sup>. Në deklaratën *vetting*, subjekti nuk ka deklaruar likuiditete *cash* jashtë sistemit bankar. Së fundmi, në vitet 2015 dhe 2016, mungon deklarimi sipas ligjit për pakësime apo shtesa të këtyre pasurive në formë likuiditetesh jashtë sistemit bankar. Subjekti pretendon se këto shuma janë përdorur për shpenzime të ndryshme të padeklaruara.

**19.4.ii.** Lidhur me mospërputhjet mes deklarimeve të gjendjeve të likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar, me fokus vitin 2010<sup>36</sup>, gjatë procesit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit u shpreh se ka pasur gabime për shkak të mungesës së përvojës në deklarime periodike vjetore, e për pasojë gjendja ndër vite e likuiditeteve nuk është mbledhur prej tij në funksion të deklarimeve periodike vjetore dhe ka shpenzime të cilat nuk janë deklaruar<sup>37</sup>. Në fjalën e tij përfundimtare, duke argumentuar sërish mungesë përvojë *duke filluar nga viti i parë i deklarimit (2003) e deri në vitin 2017 (momenti i deklarimit për efekt të procesit të rivlerësimit)*, subjekti i rivlerësimit u shpreh se gjendja e likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar në fund të çdo viti përfshin edhe kursimin dhe konsumin e atij viti dhe “[...] gjendja e likuiditeteve nuk ka pasqyruar gjendjen reale në fund të çdo viti [...]”<sup>38</sup>. Me fjalë të tjera, në funksion të procesit të rivlerësimit [në Kolegj], përkundër mospërputhjeve të konstatuara në deklaratimet e tij ndër vite, të cilat shërbejnë si bazë për të vlerësuar deklaratën e tij të pasurisë *vetting*, subjekti pretendon se ka shpenzime të padeklaruara ndër vite, që bashkë me kursimet ka deklaruar edhe shpenzime, dhe që gjendja e *cash*-it të deklaruar nuk ishte reale.

**19.4.iii.** Trupi gjykues i Kolegjit vëren se argumentet e subjektit të rivlerësimit, shtjelluar më sipër, bien ndesh me detyrimet e tij gjatë procesit të rivlerësimit, të përcaktuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës për të deklaruar me saktësi, ose plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur, në funksion të vazhdimit të qëndrimit në detyrë, sikurse edhe me detyrimet ligjore të tij si funksionar publik/subjekt i ligjit nr. 9049/2003. Më konkretisht,

<sup>35</sup> Për një krahasim, shih vlerat e deklaruara në paragrafin 19.3.iv me vlerat e deklaruara në pyetësorin e datës 24.08.2018 në paragrafin 18.4.i dhe vlerat e deklaruar në pyetësorin e datës 21.12.2018 në paragrafin 18.4.ii.

<sup>36</sup> Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2010 subjekti ka deklaruar 2.500.000 lekë gjendje *cash* në fund të vitit 2010, nga të cilat 1.000.000 kursime të vitit, ndërkohë që ka deklaruar shlyerjen e një kredie bankare me kursime të vitit. Në pyetësorin e 24.08.2018 në Komision, subjekti ka deklaruar gjendje të asaj shume [2.500.000 lekë] të gjithën *cash* jashtë sistemit bankar, pa komentuar për përdorim të saj për pagesë kredie. Nga ana tjetër, në analizat financiare të paraqitura në Kolegj, respektivisht në datat 22.07.2020 dhe 02.10.2020, vlera e *cash*-it gjendje në fund të vitit parashtrohet në 896.694 lekë dhe 1.686.242 lekë.

<sup>37</sup> Në seancën e datës 08.10.2020, subjekti i rivlerësimit tha: “Në deklaratën periodike vjetore që kam bërë në çdo vit [...] janë deklaruar të ardhurat dhe shpenzimet e atij viti. Pra, gjendja e likuiditeteve *cash* në banesë nuk është mbledhur me gjendjen e likuiditeteve *cash* për vitet e mëparshme. Çdo vit është i mëvetshëm. [...] Edhe kur janë bërë shpenzimet, janë lekë të mbledhura, likuiditete *cash* të mbledhura në vite të ndryshme, janë përdorur për një shpenzim të caktuar. Praktikisht të gjitha shpenzimet që kanë qenë mbi 300.000 (treqind mijë) lekë të reja, në bazë të ligjit janë deklaruar. [...] I vetmi problem që vjen në analizën financiare dhe deklaratat periodike është që unë gjendjen e likuiditetit *cash* nuk e kam bashkuar me gjendjen e viteve të mëparshme dhe ajo nuk pasqyron gjendjen në total të likuiditetit *cash* në banesë. [...] Janë probleme thjesht paqartësi në plotësimin e deklaratës për mungesë përvojë, po them pjesë ekonomike, nuk ka lidhje me pjesë tjetër”.

<sup>38</sup> Konkluzionet përfundimtare me shkrim, faqe 3 dhe 4.

plotësimi me saktësi dhe vërtetësi i deklaratës *vetting* ka rëndësi në zbatimin e duhur të kuadrit ligjor (neni D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016<sup>39</sup>) dhe nënligjor (udhëzimi nr. {\*\*\*}, datë 10.10.2016, i ILDKPKI-së<sup>40</sup>), të cilët parashikojnë edhe pasojën ligjore të pasaktësisë dhe pavërtetësisë në plotësimin e Shtojcës 2<sup>41</sup>. Këto rregullime kërkojnë që subjektet e rivlerësimit të deklarojnë saktësisht dhe plotësisht pasurinë – në rastin konkret likuiditete *cash* jashtë sistemit bankar – të shpjegojnë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit dhe të mos ketë përpjekje për fshehje apo pasqyrim të pasaktë. Siç është shtjelluar gjerësisht më sipër, në paragrafin 19.4.i., subjekti ka qenë kontradiktor në deklaratimet e tij, përfshirë edhe në deklaratën *vetting*.

**19.4.iv.** Pretendimet e subjektit dhe përpjekja për ta trajtuar mënyrën e deklaratimit ndër vite si “jo përpikëri” apo “mungesë përvoje”, përveç problemeve që përfaqësojnë në procesin e rivlerësimit pasuror, janë haptazi në mospërputhje edhe me detyrimet e tij si subjekt deklarues ndër vite. Pavarësisht nga ndryshimet që ka pësuar ligji nr. 9049/2003 dhe formulari, në rubrikën përkatëse, faqja 3 e formularit, që i përket pasqyrimin të shtesave dhe ndryshimeve të interesave privatë dhe pasurive të paluajtshme e të luajtshme, ligji në mënyrë konsistente ka kërkuar që subjektet deklaruese të shprehen për “[...] ndryshimet (shtesa dhe pakësime)” nga “deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklaratimit” që lidhen me zyrtarin, bashkëshortin/en dhe fëmijët madhorë [...]”. Legjislacioni në fuqi ka qenë i qartë duke parashikuar që deklaratat përbëjnë dokumente zyrtare dhe mospërmbushja e detyrimit sillte pasoja për deklaratim të rremë si vepër penale. Së fundmi, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje arsyetimin e shprehur në jurisprudencën e tij përkundër pretendimeve për kuptim të gabuar të mënyrës së deklaratimit, kur ka theksuar se:

“[...] Trupi gjykues e vlerëson ekzistencën e këtij parashikimi ligjor si një element përcaktues ndërgjegjësimit të subjekteve deklaruese në drejtim të rëndësisë së procesit dhe deklarimeve të tyre, çka nuk mund të justifikojë pretendimin e subjektit për “moskuptim të saktë të ligjit”, mbi të gjitha, në rastet kur ligji është i shprehur qartë dhe subjekti deklarues ka nivel të lartë të njohurive ligjore [...]”<sup>42</sup>.

**19.4.v.** Së dyti, pretendimi për mungesë përvoje nuk është bindës edhe sepse nuk rezulton të ketë qenë problem në vitet e para të deklaratimit, përkundrazi – subjekti ka deklaruar *gjendje cash* dhe *para të kursyera gjendja cash* për vitet 2005-2007 – qasje që përputhet me detajet e kërkuara nga ligji për deklaratimin e likuiditeteve<sup>43</sup>. Përpos këtij elementi, këto pretendime të

<sup>39</sup> Neni 33, pika 5, germa “a” e ligjit parashikon: “[...] a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe që nuk gjendet në situatë konflikti interesi; [...]”

<sup>40</sup> “Për mënyrën e deklaratimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklaratim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” – pika 17. “Deklarimi i gjendjes “cash” do të njihet si i tillë në konceptin e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklaratimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, deri në kufirin e shumës 1,5 milionë lekë. Shumat më të mëdha duhet të formalizohen në sistemin bankar, përpara dorëzimit të deklaratës në ILDKPKI, duke bashkëlidhur në çdo rast vërtetimin bankar për këtë veprim”.

<sup>41</sup> Shih faqen 59: <http://klgj.al/wp-content/uploads/2019/09/Paketa-e-Ligjeve-t%C3%AB-Reform%C3%ABs-n%C3%AB-Drejt%C3%ABsi-2018.pdf>.

“Sanksionet: Mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i deklaratës së pasurisë mund të passjellë shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, sipas ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe “Objekti i deklaratimit – “[...] d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash [...]”.

<sup>42</sup> Paragrafi 27.12.16: <http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/07/E-Islamaj-vendim-i-anonimizuar-p%C3%ABr-web.pdfvendimi>.

<sup>43</sup> Neni 4 i ligjit nr. 9049/2003, pika 1 parashikon: “Subjektet [...] deklarojnë [...] gjendjen deri në 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave privatë [...], burimet e krijimit të tyre si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë [...] d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash jashtë sistemit bankar [...] në lekë ose në valutë të huaj [...]”. Kjo përmbajtje e kësaj dispozite nuk ka pësuar ndryshime nga ligji nr. 42/2017.

subjektit bien ndesh edhe me profilin dhe përvojën e konsiderueshme profesionale të subjektit si magjistrat prokuror që ka shërbyer në pozicione që kërkojnë përgjegjësi, qartësi dhe njohuri të sofistikuar në interpretimin e ligjit, në funksion të të drejtave të individëve dhe interesit publik në ndjekjen penale. Në dritën edhe të jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit<sup>44</sup>, në kushtet kur shpjegimet mbi gjendjen e likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar bien ndesh me deklaratimet e vetë subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë, të cilat konsiderohen provë në procesin e rivlerësimit, në zbatim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dhe së bashku me deklaratën *vetting* përbëjnë të vetmen mënyrë verifikimi të ekzistencës së kësaj pasurie në funksion të procesit të rivlerësimit, pretendimet e subjektit sa i përket vlerës së *cash*-it jashtë sistemit bankar në vite të ndryshme apo dinamikës së përdorimit të tyre për të investuar shpenzime të caktuara, mbetën në nivel deklarativ.

**19.4.vi** Përpos sa është arsyetuar më sipër, përkundër argumentit që në funksion të procesit të rivlerësimit, deklaratat periodike vjetore kanë vlerë vetëm në mungesë të provave të tjera dhe gabimet në to nuk përbëjnë objekt vlerësimi nga institucionet e rivlerësimit, mbështetja në deklaratat periodike vjetore, sidomos kur në fokus janë likuiditete jashtë sistemit bankar, nuk përbën rivlerësim mbi bazën e deklaratave të mëparshme apo zbatim të një mase disiplinore me fuqi prapavepruese. Së pari, sepse siç është shtjelluar gjerësisht më sipër, mospërputhjet në deklarimin e likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar për subjektin e rivlerësimit përfshijnë deklaratën *vetting*, pyetësorët dhe qëndrimin e tij në procesin gjyqësor në Kolegj. Pa përsëritur sa është arsyetuar më sipër, ndërsa deklaratimet periodike vjetore përbëjnë dokument zyrtar sipas ligjit dhe janë të vetmet referenca të ekzistencës së likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar, dhe kanë vlerë prove në procesin e rivlerësimit [në zbatim të nenit 32 pika 5 e ligjit nr. 84/2016], analiza e deklaratës *vetting* dhe e shpjegimeve të subjekteve në proces përkundër deklaratave periodike është esenciale në vlerësimin e krijimit të pasurive në analizë të mundësive të krijimit me *burime të ligjshme*. Në këtë kuadër, lidhur me vlerësimin e kriterit pasuror, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje sa është pasqyruar në jurisprudencën e tij se:

*[...] shkeljet që lidhen me detyrimin e deklarimit të pasurive janë me natyrë të vazhduar në kohë dhe krijojnë efekte të pandërprera. Janë të vazhduara në kohë, sepse deklarimi pasuror prej subjekteve kryhet së pari përpara fillimit të detyrës dhe vazhdon rregullisht çdo vit. Bazuar në deklaratën para fillimit të detyrës, ligji kërkon pasqyrimin vetëm të ndryshimeve, shtim dhe pakësim, dhe jo deklarim nga e para. Sipas ligjit nr. 9049/2003, deklaratat periodike të interesave privatë janë dokumente zyrtare që plotësohen periodikisht, me vullnet dhe ndërgjegje të plotë nga subjektet deklaruese dhe, për pasojë, sjellin përgjegjësi për vërtetësi për zyrtarin/subjektet e rivlerësimit, në të kundërt deklarata është e rreme. Procesi i deklarimit, po sipas së njëjtës bazë ligjore, është nga natyra i vazhdueshëm dhe i përbërë nga hallka të një zinxhiri, pasuria e krijuar në vitet paraardhëse shërben si burim krijimi për pasurinë në vitet pasardhëse. Kjo është veçanërisht me rëndësi për dinamikën që përbëhet nga deklarata para fillimit të detyrës, që shoqërohet më pas vetëm me detyrimin për pasqyrimin e shtesave dhe pakësimeve ndër vite. Për këtë arsye, deklaratat e pasurisë dhe kontrolli i interesave nuk janë dokumente të izoluara, por pjesë e një zinxhiri/procesi të rregullt që, siç përcaktohet në ligj, ka për qëllim të monitorojë deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, të legjitimitetit të burimeve të krijimit të saj, detyrimeve financiare për*

<sup>44</sup> Shih vendimet nr. 6/2018, nr. 8/2018, nr. 9/2018, nr. 11/2018, nr. 12/2018, nr. 5/2019, nr. 19/2019, nr. 20/2019 etj.

*të zgjedhurit, nëpunësit publikë, për familjarët e tyre dhe për personat e lidhur me ta [...]*<sup>45</sup>.

**19.4.vii.** Për arsyet e shtjelluara më sipër, me fokus paragrafin 19.4.iv, pretendimet e subjektit të rivlerësimit për mënyrën e konceptimit të kursimit (e paraqitur edhe në formë tabelare në seancën e datës 22.07.2020 – “të ardhura minus shpenzime”) dhe se shpenzimet janë mbuluar nga kursimet e një viti më parë, janë alogjike në dritën e parashikimit të shprehur në nenin 4 të ligjit nr. 9049/2003, të formularit përkatës që kërkon shprehimisht të deklarohet *gjendja deri në 31 dhjetor* të vitit paraardhës si “shtesa dhe pakësime”<sup>46</sup> dhe të përvojës së subjektit si magjistrat në pozicione që kërkojnë njohje dhe interpretim të kthjellët të ligjit, apo si subjekt deklarues që nga viti 2003. Për rrjedhojë, këto pretendime të bëra në funksion të procesit të rivlerësimit, nuk kanë vlerë provuese. Në funksion të kontrollit të pasurisë, nga trupi gjykues, kursimet në *cash* jashtë sistemit bankar, me shtesat dhe pakësimet e tyre, u përlogaritën sipas deklarimeve të subjektit dhe personave të lidhur me të në deklaratat e interesave privatë sipas viteve përkatëse, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.

**19.4.viii.** Për sa më lart, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, pasi në deklaratën *vetting* nuk ka deklaruar gjendje *cash* prej 1.500.000 lekësh, të pretenduar përgjatë të gjithë procesit të rivlerësimit të zhvilluar në Komision dhe në Kolegj.

20. Në kuadrin e kontrollit të kriterit të vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues i Kolegjit analizo edhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të rezultateve të analizës financiare të kryer në Kolegj, kryesisht lidhur me pasqyrimin e të ardhurave nga punësimi sipas dokumentacionit mbështetës të sjellë prej tij. Po ashtu, trupi gjykues analizo edhe kërkesën e subjektit të rivlerësimit për të përlogaritur shpenzimet familjare për udhëtimet jashtë Shqipërisë në një vlerë më të ulët, dhe qëndrimin e shprehur nga Komisioneri Publik mbi vlerën provuese dhe ndikuese të këtyre akteve në rezultatet e analizës financiare paraprake.

**20.1.** Lidhur me të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij nga marrëdhëniet e punës, trupi gjykues pranoi vlerat sipas dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, duke pasqyruar vlerat e reja në të ardhurat e viteve përkatëse sipas tyre, e konkretisht:

- në vitin 2005 – shtuar në vlerën 81.152 lekë;
- në vitin 2006 – shtuar në vlerën 94.305 lekë;
- në vitin 2007 – shtuar në vlerën 5.049 lekë,;
- në vitin 2012 – shtuar në vlerën 14.996 lekë; dhe
- në vitin 2013 – shtuar në vlerën 65.876 lekë.

**20.2.** Dokumentacioni i dorëzuar në Kolegj nga subjekti i rivlerësimit për të justifikuar shpenzimet e kryera për udhëtimet jashtë shtetit, kryesisht për udhëtimet që lidhen me punën e bashkëshortes së tij, u vlerësua në raport me provat e tjera dhe çdo të dhënë apo informacion të administruar gjatë procesit të rivlerësimit. Për rrjedhojë:

a) u reduktuan shpenzimet familjare për udhëtimet e kryera jashtë Shqipërisë, nga personi i lidhur, bazuar në vërtetimet nga organizatorët e aktiviteteve apo punëdhënësi për udhëtimet e konfirmuara në kuadër të ushtrimit të detyrës dhe për emër të institucionit<sup>47</sup>;

<sup>45</sup> Shih paragrafët 64.2 dhe 64.3: [http://kpa.al/wp-content/uploads/2020/07/Vendimi-A\\_Dollapaj-i-anonimizuar.pdf](http://kpa.al/wp-content/uploads/2020/07/Vendimi-A_Dollapaj-i-anonimizuar.pdf).

<sup>46</sup> Shih poshtëshënimin nr. 43 dhe poshtëshënimin nr. 29

<sup>47</sup> Udhëtimet për të cilat shpenzimet mbuloleshin nga organizatorët apo nga institucioni i punësimit, si vijojnë: a) një (1) udhëtim në vitin 2006 [08.11.2006 - 29.11.2006], në Kinë, i cili sipas dokumentacionit konfirmonte mbulimin e shpenzimeve nga qeveria kineze; b) tri (3) udhëtime në vitin 2007, respektivisht në Kroaci

b) nuk u reduktuan shpenzimet për tri (3) udhëtime, pasi dokumentacioni i paraqitur nuk përmban të dhëna apo referencë për mbulimin e shpenzimeve të ndonjë lloji – udhëtimi, akomodimi apo qëndrimi – nga organizatorët, pritësit apo institucioni i punësimit në periudhën përkatëse [Këshilli i Ministrave]<sup>48</sup>. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit në konkluzionet përfundimtare, mbi pamundësinë e vënies në dispozicion të dokumentacionit justifikues nga organizatat ndërkombëtare, si Banka Botërore apo institucione të BE-së, për shkak të kohës së kaluar, nuk është bindës dhe, mbi të gjitha, subjekti nuk referoi dhe as provoi përpjekje të kryera prej tij për të siguruar aktet nga këto institucione, për të vërtetuar pamundësinë objektive për të disponuar dokumentacionin, sipas përcaktimit të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016<sup>49</sup>.

Deklarata nëpërmjet *e-mail*-it e një të afërmi të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit [z. G.] për të provuar mbulimin e shpenzimeve të qëndrimit dhe akomodimit për tri javë në ShBA në vitin 2007, edhe nëse për të qenë garantistë nuk konsiderohen elementet e munguara të formës së dokumentacionit, rezulton se nuk përmban të dhëna që provojnë vendqëndrimin e këtij deklaruesi në periudhën kohore në fjalë. Po ashtu, deklarata hesht për raportin e shpenzimeve të mbuluara nga deklaruesi kundrejt atyre të mbuluara nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me shpenzimet e udhëtimit, kohëzgjatjes së akomodimit dhe shpenzimeve të qëndrimit në ShBA. Z. G., nëpërmjet *e-mail*-it në llogari të një personi tjetër, bashkë me një kopje të skanuar të pasaportës dhe lejes së drejtimit të automjetit, shprehet vetëm se subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë qëndruar në shtëpinë e tij [deklaruesit] në një periudhë kohore gjatë së cilës, për të paktën disa ditë, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit duhet të ketë marrë pjesë në një kolokuim në shtetin e Georgia-s<sup>50</sup>. Të dyja dokumentet e paraqitura nga subjekti për të provuar deklaratën, kanë data lëshimi që nuk përkojnë me kohën e udhëtimit (datat e lëshimit të pasaportës dhe patentës të z. G. janë të mëvonshme, përkatësisht në vitet 2013 dhe 2018, që nënkupton gjashtë (6) vjet dhe njëmbëdhjetë (11) vjet pas vitit 2007 kur është kryer vizita). Për të gjitha këto arsye, shpenzimet për këto udhëtime u llogariten në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, sipas metodologjisë së Kolegjit<sup>51</sup>, sikurse ishte përcaktuar në analizën financiare paraprake.

**20.3.** Lidhur me udhëtimet jashtë Shqipërisë të kryera për arsye personale/familjare nga subjekti i rivlerësimit, bashkëshortja dhe djali i tij, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se:

a) për udhëtimin e kryer në Bruksel, në vitin 2005, deklarata e znj. A.P. nëpërmjet *e-mail*-it, përveç mungesës së elementeve të formës, edhe nëse abstragohet prej tyre, nuk është e plotë dhe bindëse, pasi dokumentacioni i skanuar në *e-mail* [pasaporta] nuk provon vendqëndrimin e saj në Belgjikë në periudhën në fjalë [pasaporta është lëshuar në vitin 2016, 11 vjet më pas]. Për rrjedhojë, shpenzimet për këtë udhëtim u llogaritën në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, sikurse ishte përcaktuar në analizën financiare paraprake;

b) për udhëtimin e kryer në ShBA, në vitin 2007, nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, sikurse u trajtua edhe në paragrafin e mësipërm 20.2., shpenzimet e këtij

---

[24.04.2007–27.04.2007], Hungari [24.06.2007 – 28.06.2007] dhe Holandë [10.10.2007 – 14.10.2007] pasi, sipas dokumentacionit të administruar, shpenzimet ishin të mbuluara nga misioni Euralius dhe fondet e projektit SMEI.

<sup>48</sup> Udhëtimet e kryera respektivisht në Francë në periudhën 23.02.2007 – 01.03.2007, në Britaninë e Madhe në 01.05.2006 – 13.05.2006 dhe në ShBA në 09.11.2007 – 28.11.2007.

<sup>49</sup> Neni 32, pika 2 parashikon: “[...] 2. Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor [...]”.

<sup>50</sup> Shih aktin e referuar në paragrafët 16.7 dhe 16.2.iv më sipër.

<sup>51</sup> Për më shumë, vendimi nr. 11/2019 (faqe 26 e në vijim): <http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/07/E-Islamaj-vendim-i-anonimizuar-p%C3%ABr-web.pdf>

udhëtimi u llogaritën në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, sikurse ishte përcaktuar në analizën financiare paraprake;

c) për udhëtimet e kryera në Kinë në vitet 2006 dhe 2007 nga subjekti i rivlerësimit, bashkëshortja<sup>52</sup> dhe djali, shpjegimi i subjektit të rivlerësimit për qëndrim të prindërit e tij gjatë kohës kur i ati ishte ambasador i Republikës së Shqipërisë atje, ishte bindës<sup>53</sup>. Për rrjedhojë, shpenzimet e akomodimit për këto udhëtime nuk u llogariten në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, ndërsa u përlllogaritën vetëm shpenzimet ditore prej 5 dollarësh amerikanë për çdo ditë qëndrimi, për secilin, sipas metodologjisë së Kolegjit. Nga ana tjetër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se biletat e udhëtimit janë paguar nga babai i tij për udhëtimet e kryera në periudhën 04.09.2006 – 29.09.2006<sup>54</sup>, në periudhën 12.07.2007 - 21.07.2007<sup>55</sup> dhe në periudhën 04.09.2007 – 27.09.2007<sup>56</sup>, nuk u provuan në asnjë formë me asnjë dokumentacion. Ky pretendim mbeti deklarativ edhe në dritën e faktit që ky përfitim nuk është deklaruar as në deklaratat e interesave privatë për vitet 2006 dhe 2007, në rubrikën “Dhurata dhe trajtime preferenciale”. Për rrjedhojë, shpenzimet e biletave u llogaritën në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, sipas metodologjisë së Kolegjit<sup>57</sup>;

ç) për udhëtimin e kryer në Kinë, shpenzimet për sa i përket djalit të subjektit të rivlerësimit në periudhën 08.11.2006 – 29.11.2006, u reduktuan në mënyrë përpjesëtimore në analizën financiare;

d) për udhëtimet në Turqi dhe Çeki në vitin 2007, si dhe për udhëtimet e tjera 1-3-ditore në vitet 2006 dhe 2007, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti dokumente dhe akte që të provonte vlerën e shpenzimeve të kryera dhe të pretenduara. Për rrjedhojë, shpenzimet për këto udhëtime u llogaritën në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, sipas metodologjisë së Kolegjit<sup>58</sup>, sikurse ishin përcaktuar në analizën financiare paraprake.

**20.4.** Për sa i përket gjendjes së likuiditeteve *cash*, në kushtet kur shpjegimet e subjektit mbetën në nivel deklarativ, bazuar edhe në arsyetimin e mësipërm në paragrafin 19.4 dhe nënparagrafët e tij, vlera e tyre u llogarit sipas pasqyrimin në deklaratat e interesave privatë për vitet 2005 - 2014.

**20.5.** Në vijim, referuar arsyetimit në paragrafët e mësipërm, rezultatet e analizës financiare për subjektin e rivlerësimit dhe personit të lidhur me të u rishikuan dhe pamjaftueshmëria e burimeve të ligjshme për të mbuluar shpenzimet për vitet 2003 - 2016, u reduktua në vlerën përfundimtare prej 2.463.724 lekësh<sup>59</sup>.

**20.6.** Për sa më lart, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të paplotë dhe të pasaktë të pasurive të tij në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, duke u përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë e tij në formën e likuiditetit gjendje *cash*, dhe për shkak se rezultoi me mungesë të burimeve

<sup>52</sup> Referuar udhëtimeve në Kinë që nuk lidhen me punën e saj, sikurse udhëtimi në periudhën 04.09.2006 - 29.09.2006 dhe në periudhën 04.09.2007 – 27.09.2007.

<sup>53</sup> Komisioni ka administruar në provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ: dekretin nr. 4739, datë 28.12.2005, të Presidentit të Republikës “Për emërim ambasadori” dhe dekretin nr. 6911, datë 25.02.2011, të Presidentit të Republikës “Për lirim ambasadori nga detyra”, për emërimin në vitin 2005 dhe lirimin në vitin 2011 të z. M.P. në/nga detyra e ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqplotë të Republikës së Shqipërisë në Republikën Popullore të Kinës.

<sup>54</sup> Udhëtim i kryer nga subjekti i rivlerësimit, bashkëshortja dhe djali.

<sup>55</sup> Udhëtim i kryer vetëm nga subjekti i rivlerësimit.

<sup>56</sup> Udhëtim i kryer nga bashkëshortja dhe djali i subjektit të rivlerësimit.

<sup>57</sup> Për më shumë, vendimi nr. 11/2019 (faqe 26 e në vijim): <http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/07/E-Islamaj-vendim-i-anonizuar-p%C3%ABr-web.pdf>.

<sup>58</sup> Idem.

<sup>59</sup> Nga analiza e kryer në Kolegj, pas shqyrtimit të kërtimeve të Komisionerit Publik dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti në seancat publike në Kolegj [pas analizës paraprake], kjo vlerë thellohet në 3.251.776 lekë balancë negative.

financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, në përputhje me nenin D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe në kuptim të nenit 33, pika 5, germat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

### *Ç. Konkluzione përfundimtare*

21. Trupi gjykues i Kolegjit shqyrtoi çështjen në tërësi dhe mori në shqyrtim provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe, pasi dëgjoi edhe konkluzionet përfundimtare të palëve, vlerësoi shkaqet e ankimit të referuara nga Komisioneri Publik, si edhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit në kundërshtim të shkaqeve të ankimit, bazuar në aktet e administruara në dosjen gjyqësore, si dhe në legjislacionin e zbatueshëm, sipas kriterëve të procesit të rivlerësimit, konstatoi sa vijon.

**21.1.** Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë:

a) subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 pasi në deklaratën *vetting* nuk ka deklaruar gjendje *cash* prej 1,5 milionë lekësh të pretenduara më pas gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, përfshirë edhe në seancën publike në Kolegji;

b) për mundësinë e mbulimit me të ardhura të ligjshme të pasurive të krijuara (të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete në bankë, kursime *cash* të deklaruara) dhe shpenzimet e kryera përgjatë periudhës 2003 – 2016, nga analiza financiare e kryer në Kolegji, në analizë të dokumentacionit të sjellë nga subjekti i rivlerësimit dhe qëndrimit të shprehur nga Komisioneri Publik, në përfundim rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë se kishte mundësi financiare për të mbuluar me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e deklaruara dhe të pretenduara gjatë procesit të rivlerësimit. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me mospërputhjet në deklarime të likuiditeteve *cash*, në kushtet kur kjo pasuri gjendet jashtë sistemit bankar dhe kur e vetmja mënyrë verifikimi janë deklaratimet në deklaratat periodike vjetore, mbetën të paargumentuara bindshëm dhe në nivel deklarativ.

**21.2.** Për rrjedhojë të sa më sipër, trupi gjykues çmon se për kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklaratimit të paplotë dhe të pasaktë të pasurive të tij në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, duke u përprekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë e tij në formën e likuiditetit *cash*, dhe për shkak se rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, në përputhje me nenin D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe në kuptim të nenit 33, pika 5, germat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

**21.3.** Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së tij, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe ndaj tij duhet të vendoset masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

22. Sa u përket shkaqeve të tjera të ankimit të paraqitura nga Komisioneri Publik, trupi gjykues vlerëson se konkluzionet lidhur me kontrollin e pasurive të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*, janë të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin përfundimtar lidhur me kriterin e kontrollit të pasurisë dhe vlerësimin se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të dhe, si pasojë, ndaj tij duhet të vendoset masa disiplinore e shkarkimit nga detyra. Si rrjedhojë, vendimi nr. 112, datë 04.03.2019, i Komisionit duhet ndryshuar pasi nuk gjendet i drejtë dhe i bazuar në fakte, prova dhe ligj.

## **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Ndryshimin e vendimit nr. 112, datë 04.03.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Dritan Peka.
2. Ky vendim është përfundimtar, me efekt të menjëhershëm.

U shpall sot në Tiranë, më datë 22.10.2020.

**GJYQTARE**

**INA RAMA**

*nënshkrimi*

**GJYQTAR**

**ARDIAN HAJDARI**

*nënshkrimi*

**GJYQTAR**

**SOKOL ÇOMO**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**REZARTA SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**NATASHA MULAJ**

*nënshkrimi*